

VENDIM
Nr. 215, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAS SHA”, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 13, pika 1; nenit 16, pika 2; neni 17, germa “e” dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenit 21, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/9 prot., datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaaz sh.a., për vitin 2021”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 60, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s vendosi: “Miratimin e përkohshëm të tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaaz sh.a. prej 28 lek/m³ ose 2.6457 lek/kwh, deri më 31.12.2019”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, është miratuar lënia në fuqi e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaaz sh.a., për vitin 2020”.

- Në kushtet kur shoqëria ALBGAS sh.a.:

- nuk ka paraqitur ende aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit, për periudhën e ardhshme rregullatore, në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”;

- në vijim të paraqitjes së planit të zhvillimit të rrjetit, për periudhën 2019–2028, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, nga ana e ERE-s është kërkuar qëndrimi i shoqërisë Albgaaz sh.a. në lidhje me zbatueshmërinë e planit 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, si pasojë e konstatimeve të ERE-s mbi planin dhe situatën e krijuar nga gjendja e pandemisë në Republikën e Shqipërisë;

- tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria Albgaaz sh.a., i cili ushtrohet konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE;

- nuk ka paraqitur ende pasqyrat financiare për vitin 2019, si rrjedhojë edhe e shtyrjes së afatit nga qeveria shqiptare për pasojë të situatës së krijuar nga gjendja e jashtëzakonshme, shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2021, deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albgaaz sh.a.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë Albgaaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti